

Sekretari i Këshillit Bashkiak

1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak, mbi bazën e propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.

2. Sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës për:

1. mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
2. ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve sipas rendit të ditës;
3. njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
4. shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga këshilli bashkiak;
5. përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
6. mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.

3. Sekretari i këshillit bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

Sekretari i Këshillit Bashkiak për Bashkinë Korçë është Eva Naçi.